

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: Seykos SH.P.K.; SELMANS NETWORK SH.P.K., 28 Nëntori - Daradani – PRISHTINË Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	04.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **03.07.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Seykos SH.P.K.; SELMANS NETWORK SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Seykos SH.P.K.; SELMANS NETWORK SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **29.06.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: Seykos SH.P.K.; SELMANS NETWORK SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **29.06.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **03.07.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit, duke u thirrur në Ligjin mbi Prokurimin Publik:

Ju bashkëngjisim edhe njëherë Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Sqarimet janë si në vijim:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë ne listën të paktën këtë staf profesional

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 6 vite pas diplomimit, të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar për kërkesën Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me vendim për Menaxheri i Projektit keni prezantuar, z. Fatmir Kryeziu, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës;

Në ofertën e juaj të dorëzuar, nuk keni ofruar dëshmi se Inxhinieri ne fjale të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës, ku dokumenti në fjale nuk mund të kërkohej ne baze të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

2.4. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar për kërkesën Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master, keni prezantuar, z. Afrim Gashi, nga dëshmitë e kërkuar dokumentare është kërkuar: *Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt*; Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, por marrëveshje e dorëzuar nuk është për projektin në fjalë, ku dokumenti në fjale nuk mund te kërkohej ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së*

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit